

1. Gjëndja shëndetsore dhe trajtimi

Mjeku ju ka shpjeguar gjëndjen shëndetsore në të cilën ndodhni.

Ajo është: _____

Kjo gjëndje shëndetsore kërkon procedurën e mësipërme për të kryer diagnostikimin.

Gjatë kësaj procedure ekzaminuese një sondë me ultratinguj në formën e një tubi të përkulshëm do të futet nëpërmjet gojës në ezofag (tubi nëpërmjet të cilit ushqimi kalon në stomak). Sonda do të qëndrojë aty për 15 deri në 20 minuta deri sa të përfundojë testi. Ky ekzaminim kryhet për të marrë pamje (në ultratinguj) më të detajuara të zembrës tuaj, nga ç'do të ishte e mundur me një ekografi trans-torakale (të zakonshme).

2. Risqet e Ekografisë Trans-Ezofageale

Kjo procedurë ekzaminuese ka risqe dhe komplikacione të mundshme.

Risqe dhe komplikacione të zakonshme (më shumë se 5%) përfshijnë:

- Dhimbje fyti pas procedurës.

Risqe dhe komplikacione të rralla (1-5%) përfshijnë:

- Gërvitje në ezofag, të cilat zakonisht kalojnë pa nevojën e trajtimeve.

Risqe dhe komplikacione shumë të rralla (më pak se 1%) përfshijnë:

- Rrahje zemre jo normale që zakonisht kalojnë pa nevojën e trajtimeve.
- Probleme me frymëmarrjen. Kjo mund të ketë nevojë për trajtime të mëtejshme.
- Perforacion (vrimë) në ezofag. Mund të ketë nevojë për trajtime të mëtejshme, në disa raste edhe për ndërhyrje kirurgjikale.
- Vdekja si pasojë e komplikacioneve gjatë kësaj procedure ekzaminuese është jashtëzakonisht shumë e rrallë.

3. Risqet e të moskryerit të kësaj procedure

(Mjeku ti paraqesi në hapsirën e mëposhtme. Të vazhdojnë në kartelën mjeksore nëse është e nevojshme)

4. Konsensusi i pacientit

Pranoj se mjeku më ka shpjeguar;

- Gjëndjen time shëndetsore dhe procedurën ekzaminuese të propozuar, duke përfshirë trajtime të mëtejshme nëse mjeku gjen diçka të paparashikuar. Unë i kuptoj risqet, duke përfshirë dhe risqet që janë specifike për mua.
- Procedurën e sedacionit të nevojshme për këtë ekzaminim. Unë i kuptoj risqet, duke përfshirë dhe risqet që janë specifike për mua.
- Procedura/trajtime të tjera të pershtatshme dhe risqet e tyre.

- Prespektivën e gjëndjes time shëndetsore dhe risqet e moskryerjes së kësaj procedure ekzaminuese.
- Unë isha në gjëndje të bëj pyetje dhe të diskutoj me mjekun për gjëndjen time shëndetsore, për procedurën ekzaminuese të propozuar dhe risqet e saj, si dhe për mundësitë e trajtimit. Pyetjet dhe shqetësimet e mia janë diskutuar dhe kanë marrë përgjigje në mënyre të kënaqshme.
- Jam i/e ndërgjegjshëm/e se kam të drejtë të ndryshoj mendje në çdo moment, edhe pasi të kem firmosur këtë formular.
- Jam i/e ndërgjegjshëm/e se gjatë kësaj procedure do të kryhen fotografi ose regjistrime të cilat do të ndihmojnë mjekun në diagnostikimin e gjëndjes time shëndetsore.

5. Deklarata e pacientit

Në bazë të deklaratës së mësipërme, unë kërkoj të kryej procedurën ekzaminuese të lartpërmendur

Emri/Mbiemri: _____

Firma: _____

Data: ____/____/____

6. Deklarata e mjekut

I kam shpjeguar pacientit të gjithë pikat e mësipërme dhe jam i medimit se pacienti /shoqëruesi e kanë kuptuar këtë informacion.

Emri/Mbiemri: _____

Firma: _____

Data: ____/____/____